

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË "PERSPEKTIVE" Shpk**

Sot, në Tiranë, më 11.05.2023 në përputhje me kriteret e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, u hartua ky Akt Themelimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara me ortak themelues:

**Z. TOBIA FIOCCHETTI** lindur ne Marsciano me 17 Prill 1976 rezident ne Itali ne rruga Benedetto Croce 2/b Marsciano (PG) me dokument identifikimi pashaporte YB4047205

I cili vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi të Shoqërisë "**PERSPEKTIVE**" **Shpk** në bazë të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, të ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, Kodit Doganor, Kodit Fiskal, si vijon:

**KAPITULLI 1**

**Neni 1**  
**Themelimi**

Shoqëria « **PERSPEKTIVE** » **Shpk** është person juridik i të drejtës juridike shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu në vijim do të referohet si "Shoqëria").

**Neni 2**  
**Personaliteti Juridik**

Shoqëria përfiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendren e Regjistrimit të Kompanive sipas kërkesave dhe procedurave që parashikon Ligji.

Shoqëria, pasi përfiton personalitetin juridik, është përgjegjëse kundrejt palëve të treta për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.

Shoqëria » **PERSPEKTIVE** » **Shpk** është një shoqëri, e themeluar midis ortakëve që u përgjigjen humbjeve deri në limitin e vlerës së kontribuar në kapitalin e shoqërisë.

**Neni 3**  
**Selia**

Shoqëria ka selinë në Tiranë Sheshi Skenderbeg Pallati Kulturës, Kati II, Hyrja 26.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, mund të hapë zyra përfaqësie, filiale, mund të krijojë degë si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Articolo 4**  
**Objekt i aktivitetit**

Shoqëria ka si objekt :



Konsulenze per ndermarrjet ne fusha te ndryshme , konsulenze per promovime ne marketing

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë "PERSPEKTIVE" shpk është fiksuar deri më 31 Dhjetor 2050.

**KAPITULLI 2**  
**KAPITALI**

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 leke (dhjetemije)

**Z. TOBIA FIOCCHETTI** lindur ne Marsciano me 17 Prill 1976 rezident ne Itali ne rruga Benedetto Croce 2/b Marsciano (PG) me dokument identifikimi pashaporte YB4047205

Zotëron një kuotë të barabartë me vlerën e 10.000 leke që përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga vlera të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të derdhet në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/pasuri të paluajtshme ose të drejta).

Ortaku që cënohet të ushtrojë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i pjesës në shoqëri, ka të drejtë të kërkojë nga gjykata urdhër ndalimin e shkeljes ose shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë ushtrohet brenda 3 viteve nga momenti i shkeljes.

**Neni 7**  
**Mënyra e transferimit të kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b) shitjes,
- c) trashëgimisë,
- d) dhurimit,
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

Në rastin e kalimit të aksioneve me kontratë, kjo kontratë duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund ta kushtëzojë transferimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin ose të drejtën e parablerjes së shoqërisë në favor të shoqërisë ose ortakëve të tjerë.



Në rastin e transferimit të kuotave me kontratë, afatet dhe kushtet e transferimit të titullit të kuotës, si dhe kushtet e tjera kalimtare, duke përfshirë pagesën për blerjen e kuotave, rregullohen nga kontrata. Kontrata për transferimin e kuotave hartohet me shkrim dhe noterizimi nuk është kusht për vlefshmërinë ose regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj ose kur palët bien dakord për një kontratë, vlefshmëria, e së cilës, për kalimin e titullit të pronësisë mbi kuotat, nuk i nënshtrohet procedurave administrative të ndryshme me efekt deklarues, përfshirë këtu edhe procedurat e regjistrimit ose publikimit të kontratës ose transferimit të titullit.

### **KAPITULLI III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE MENAXHUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi i Vendimmarrjes**

Asambleja e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës në Shoqëri.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton ndryshimet në statut sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimet e marra nga shoqëria për sa vijon:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet statutore;
- c. emërimi dhe shkarkimin e Administratorëve;
- ç. emërimi dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimi dhe shpërblimi i personave të cituar në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh. mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
- e. miratim të bilanceve vjetore dhe raporteve mbi progresin e biznesit;
- f. rritje dhe zvogëlim të kapitalit;
- g. ndarja e kuotave si dhe anulimi i tyre;
- h. përfaqësimi i shoqërisë në gjykim dhe procedime të tjera kundrejt Administratorëve;
- i. riorganizim dhe shpërbërje të shoqërisë;
- j. miratimi i rregullave procedurale për mbledhjet e Asamblesë;
- k. kërkojë kredi pranë çdo banke ose institucioni financiar.
- l. Çështje të tjera të parashikuara në ligj ose në Statut.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, nga një ortak tjetër ose nga një palë e tretë me anë të një autorizimi.

Drejtori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për pjesëmarrje në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet e ardhshme që do të kenë të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9 Administrimi**

**Z. TOBIA FIOCCHETTI** lindur ne Marsciano me 17 Prill 1976 rezident ne Itali ne rruga Benedetto Croce 2/b Marsciano (PG) me dokument identifikimi pashaporte



YB4047205 është administrator i shoqërisë për një periudhë (5) vjetë me të drejtë rinovimi duke filluar nga data 11.05.2023 – 11.05.2028.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë kur arrihet shumica. Statuti ose marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë.

Gjithashtu, Administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të njërit prej ortakëve.

Të drejtat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre duhet të njoftohen për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person, jo ortak.

### **Neni 10** **Kompetencat**

Administratori autorizohet dhe ka detyrimin të:


- a) kryejë të gjitha operacionet e administrimit të aktivitetit tregtar, duke aplikuar politikën tregtare të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare.
- c) ofrojë asistencë për mirëmbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë.
- ç) hartojë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe ia dorëzon këto dokumente Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë.
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme për shoqërinë, sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- e) raportojë së pari para Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe zbatimin e veprimeve specifike me rëndësi të veçantë për biznesin e shoqërisë tregtare.
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe Statuti.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e zakonshme të menaxhimit. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë dhe juridikë, autoriteteve publike dhe/ose private, vendase ose të huaja, shqiptare ose të huaja, përfshirë autoritetet gjyqësore të të gjitha niveleve, bankat e të gjitha niveleve, etj. Administratori ka kompetencë të veprimit në marrëdhënie me të tretët për llogari të shoqërisë, si dhe para bankave të të gjitha niveleve, të kryejë transfertat, tërheqje etj., pranë zyrave të tatimeve, zyrave të administratës vendore, punës, doganave, autoritetet etj. në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji u jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori e përfshin shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve në përputhje me objektin e tij të veprimtarisë.

### **Neni 11** **Viti Fiskal**

Viti financiar i kompanisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor.



**Neni 12**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë akt, zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të Kodit Civil dhe të çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 13**  
**Mosmarrëveshjet**

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit dhe interpretimit të këtij akti themelues, si dhe për mosmarrëveshjet e tjera që mund të lindin ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

**Neni 14**  
**Dispozitat përfundimtare**

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 kopje me të njëjtën vlerë ligjore, në shqip dhe italisht dhe është miratuar nga aksionerët e shoqërisë tregtare **PERSPEKTIVE Shpk** dhe është nënshkruar në të gjitha kopjet duke shkruar emrin, mbiemrin, dhe firmën origjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

**I SHOQËRISË "PERSPEKTIVE" Shpk**

TOBIA FIOCCHETTI



**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“PERSPEKTIVE” Shpk**

Sot, në Tiranë, më 11.05.2023 në përputhje me kriteret e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, u hartua ky Statut i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara me ortak themelues:

**Z. TOBIA FIOCCHETTI** lindur ne Marsciano me 17 Prill 1976 rezident ne Itali ne rruga Benedetto Croce 2/b Marsciano (PG) me dokument identifikimi pashaporte YB4047205

I cili vendosi të hartojë këtë Statut të Shoqërisë “PERSPEKTIVE” Shpk në bazë të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, të ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, Kodit Doganor, Kodit Fiskal, si vijon:

**KAPITULLI 1**

**Neni 1**  
**Themelimi**

Shoqëria “PERSPEKTIVE ” **Shpk** është person juridik i të drejtës juridike shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu në vijim do të referohet si “Shoqëria”).

**Neni 2**

Shoqëria " PERSPEKTIVE ” **Shpk** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ortakët, e cila nuk përgjigjet për borxhet e kontraktuara nga shoqëria dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e jashtëzakonshme të kontributeve të nënshkruara.

Kontributi i Ortakut përfaqëson kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon pjesën e tij në shoqëri, në raport me kontributet e paguara në kapitalin shoqëror.

**Neni 3**  
**Selia**

Shoqëria ka selinë në Tiranë Sheshi Skenderbeg Pallati Kulturës, Kati II, Hyrja 26.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, mund të hapë zyra përfaqësie, filiale, mund të krijojë degë si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 4**  
**Objekt i aktivitetit**



Shoqëria ka si objekt :

Konsulenze per ndermarrjet ne fusha te ndryshme , konsulenze per promovime ne marketing

## **Neni 5** **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë « **PERSPEKTIVE**» **Shpk** është fiksuar deri më 31 Dhjetor 2050.

## **KAPITULLI 2** **KAPITALI**

### **Articolo 6** **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 leke(dhjetemije).

**Z. TOBIA FIOCCHETTI** lindur ne Marsciano me 17 Prill 1976 rezident ne Itali ne rruga Benedetto Croce 2/b Marsciano (PG) Zotëron një kuotë të barabartë me vlerën 10.000 leke që përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga vlera të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të derdhet në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/pasuri të paluajtshme ose të drejta).

Ortaku që cënohet të ushtrojë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i pjesës në shoqëri, ka të drejtë të kërkojë nga gjykata urdhër ndalimin e shkeljes ose shpërblimin e dëmit të shkakuar si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë ushtrohet brenda 3 viteve nga momenti i shkeljes.

### **Neni 7** **Rritje dhe zvogëlim i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të rritet me nënshkrimin e pjesëve të kapitalit në përdorim për kontribute në të holla dhe kontribute në natyrë, me caktimin nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute me kërkesë të administratorit.

Në çdo rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak të rrisë pjesën e tij të kapitalit të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit aprovohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.  
Në të gjitha rastet, ulja e kapitalit është në përpjesëtim me pjesët takuese të kapitalit që përfaqësojnë Ortakët.



Vendimi për zvogëlimin e kapitalit, i komunikohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, nga administratori, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

### **Neni 8**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b) shitjes,
- c) trashëgimisë,
- d) dhurimit,
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

Në rastin e kalimit të aksioneve me kontratë, kjo kontratë duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund ta kushtëzojë transferimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin ose të drejtën e parablerjes së shoqërisë në favor të shoqërisë ose ortakëve të tjerë.

Në rastin e transferimit të kuotave me kontratë, afatet dhe kushtet e transferimit të titullit të kuotës, si dhe kushtet e tjera kalimtare, duke përfshirë pagesën për blerjen e kuotave, rregullohen nga kontrata. Kontrata për transferimin e kuotave hartohet me shkrim dhe noterizimi nuk është kusht për vlefshmërinë ose regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj ose kur palët bien dakord për një kontratë, vlefshmëria, e së cilës, për kalimin e titullit të pronësisë mbi kuotat, nuk i nënshtrohet procedurave administrative të ndryshme me efekt deklarues, përfshirë këtu edhe procedurat e regjistrimit ose publikimit të kontratës ose transferimit të titullit.

## **KAPITULLI III**

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE MENAXHUESE**

#### **Neni 9**

#### **Organi i Vendimmarrjes**

Asambleja e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës në Shoqëri.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton ndryshimet në statut sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimet e marra nga shoqëria për sa vijon:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet statutore;
- c. emërimi dhe heqja e Administratorëve;
- ç. Emërimi dhe heqja e likujdatorëve dhe e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimi dhe shpërblimi i personave të cituar në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh. Mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
- e. miratim të bilanceve vjetore dhe raporteve mbi progresin e biznesit;
- f. rritje dhe zvogëlim të kapitalit;



- g. ndarja e kuotave si dhe anulimi i tyre;
- h. përfaqësimi i shoqërisë në gjykim dhe procedime të tjera kundrejt Administratorëve;
- i. riorganizim dhe shpërbërje të shoqërisë;
- j. miratimi i rregullave procedurale për mbledhjet e Asamblesë;
- k. kërkojë kredi pranë çdo banke ose institucioni financiar.
- l. Çështje të tjera të parashikuara në ligj ose në Statut.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, nga një ortak tjetër ose nga një palë e tretë me anë të një autorizimi.

Drejtori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për pjesëmarrje në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet e ardhshme që do të kenë të njëjtin rend dite.

### **Neni 10**

#### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Mbledhja e përgjithshme thirret me komunikim me shkrim ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim me e-mail. Njoftimi me letër ose e-mail duhet të tregojë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me pikën 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët pranojnë të marrin vendime pavarësisht nga parregullsia.

### **Neni 11**

#### **Kuorumi**

Në rastin e vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të diskutojë në mënyrë të vlefshme vetëm nëse Ortakët me të drejtë vote zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rast se mbledhja vendos për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë personalisht të pranishëm Ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave, duke votuar me anë të një letre ose me mjete elektronike, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë nen, mbledhja do të thirret sërish jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 12**

#### **Proçesi i vendimmarrjes**

Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të Ortakëve pjesëmarrës ndryshimin e statutit, rritjen ose pakësimin e kapitalit themeltar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë votash të Ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si p.sh:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;



- b. ndryshimet statutore;
- c. emërimi dhe shkarkimin e Administratorëve;
- ç. Emërimi dhe shkarkimin e likujdatorëve dhe e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimit
- dh. Mbikëqyrja mbi zbatimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e bilanceve vjetore dhe raportet mbi progresin e biznesit;
- e. përfaqësimi i shoqërisë në procese gjyqësore dhe procedime të tjera kundrejt Administratorëve;
- f. aprovimi i procedurave rregullatore të mbledhjeve të Asamblesë

Çdo ndryshim ligjor duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për t'u pasqyruar në dosjen e shoqërisë.

### **Neni 13** **Administrimi**

**Z. TOBIA FIOCCHETTI** lindur ne Marsciano me 17 Prill 1976 rezident ne Itali ne rruga Benedetto Croce 2/b Marsciano (PG) me dokument identifikimi pashaporte YB4047205 është Administrator sipas Statutit dhe Ligjit për një periudhë kohore prej (5) pese vitesh me të drejtë rinovimi duke filluar nga data 11.05.2023 – 11.0.2028. Asambleja e përgjithshme mund ti shkarkojë administratorët në çdo kohë kur arrihet shumica. Statuti ose marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë.

Gjithashtu, Administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të njërit prej ortakëve.

Të drejtat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre duhet të njoftohen për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person, jo ortak.

### **Neni 14** **Kompetencat**

Administratori autorizohet dhe ka detyrimin të:

- a) kryejë të gjitha operacionet e administrimit të aktivitetit tregtar, duke aplikuar politikat tregtare të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare.
- c) ofrojë asistencë për mirëmbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë.
- ç) hartojë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe ia dorëzon këto dokumente Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë.
- Dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme për shoqërinë, sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- e) raportojë së pari para Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe zbatimin e veprimeve specifike me rëndësi të veçantë për biznesin e shoqërisë tregtare.



Ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe Statuti.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e zakonshme të menaxhimit. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë dhe juridikë, autoriteteve publike dhe/ose private, vendase ose të huaja, shqiptare ose të huaja, përfshirë autoritetet gjyqësore të të gjitha niveleve, bankat e të gjitha niveleve, etj. Administratori ka kompetencë të veprojë në marrëdhënie me të tretët për llogari të shoqërisë, si dhe para bankave të të gjitha niveleve, të kryejë transferta, tërheqje etj., pranë zyrave të tatimeve, zyrave të administratës vendore, punës, doganave. Autoritetet etj. Në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji u jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori e përfshin shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve në përputhje me objektin e tij të veprimtarisë.

### **Neni 15** **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori përgjigjet personalisht për shoqërinë ose për të tretët, për shkelje të ligjit, për shkelje të statutit ose për shkelje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që dëmtojnë shoqërinë, i ngarkohen Administratorit ose ortakëve që kanë lidhur marrëveshjen për t'u marrë individualisht ose bashkërisht me pasojat e rastit në fjalë.

Me përjashtim të asaj që parashikohet nga dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, në zbatim të neneve 14, 15, 17, 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori është i detyruar të:

- 1). A) kryejë funksionet e tij, të përcaktuara në legjislacion dhe statut, në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në përgjithësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë në kontekstin social.
- b) ushtrojë kompetencat e njohura në ligj dhe statut vetëm për të arritur objektivat e përcaktuara në këto dispozita.
- c) shqyrtojnë me përgjegjësi maksimale çështjet për të cilat marrin vendime.
- Ç) parandalojnë dhe shmangin rastet e konfliktit aktual ose të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë.
- d) të ushtrojë funksionet e tij me profesionalizëm dhe përgjegjësi maksimale.
- 2) Administratori gjatë ushtrimit të detyrës i përgjigjet shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të pyetjeve dhe vlerësimit të informacionit përkatës, akti i veprimit ose mosveprimit është kryer në mirëbesim.
- 3) Në rast se Administratori vepron në kundërshtim me detyrat e tij dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ai është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nga shkelja dhe i kërkohet të kthejë fitimet që, ai dhe personat e lidhur, kanë gjeneruar, nga këto veprime të parregullta.

Administratori ka për detyrë të tregojë dëshmi për kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me standardet e kërkuara. Kur shkelja kryhet nga më shumë se një Administrator, këta të fundit janë të detyruar t'i përgjigjen bashkërisht shoqërisë.

4) Në veçanti, por jo ekskluzivisht, Administratori është i detyruar t'i shlyejë shoqërisë çdo dëm të shkaktuar, në rast se bie ndesh me ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duke kryer veprimet e mëposhtme:

A) shlyerjen e kontributeve për Ortakët;



- B) pagesë të interesave ose të dividendit Ortakëve;
- C) ndarjen e aktivitetit të shoqërisë
- D) jep kredi

Me përjashtim të kundërshtimeve personale ndaj administratorit, Ortakët, individualisht ose kolektivisht, ushtrojnë të drejtën për të bërë kallëzim penal kundër administratorit.

Kërkesit kanë të drejtë të kërkojnë pagesën e plotë të 12emit të shkaktuar ndaj shoqërisë, duke përfshirë kompensimin financiar nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndërpresë ngritjen e padisë ndaj Administratorit për lëshimet e kryera prej tij në ushtrimin e detyrës.

### **Neni 16** **Viti Fiskal**

Viti financiar i kompanisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon në datën 31 Dhjetor.

### **Neni 17** **Bilanci i Shoqërisë dhe Dividendi**

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit fiskal, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë vendos për shpërndarjen e dividendit, pas zbritjes së humbjeve të vitit fiskal të mëparshëm, siç e kërkon ligji.

### **Neni 18** **Ekspertët**

Ekspertët kanë detyrimin të kontrollojnë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë për të gjithë vitin dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të kryera prej tij në rastet kur ngarkohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Për qëllime të kontrollit nga ana e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, përgatitet raporti me shkrim për nxjerrjen e rezultateve të bilanceve vjetore edhe për atë të kontroleve periodike të ushtruara, i cili duhet t'i paraqitet në kohë Asamblesë së Përgjithshme për t'u shqyrtuar dhe miratuar.

### **Neni 19**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shpërndahet:

- a) kur përfundon kohëzgjatja për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurës së falimentimit në rast të burimeve të pamjaftueshme kapitale për të mbuluar kostot e parashikuara nga procedura e falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i përealizueshëm për shkak të pjesës kontraktore ose mospërbushjes së detyrave të organeve të shoqërisë ose për arsye të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- 5) në raste të tjera të parashikuara nga Statuti;
- dh) në raste të tjera të parashikuara nga Ligji;
- e) për çdo rast tjetër e vendosur nga Asambleja e Ortakëve;



2. Shpërndarja e shoqërisë për një ose më shumë arsye të parashikuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e" të pikës 1 të këtij neni, vendoset me shumicën e aksionarëve. Mbledhje, paragrafi i dytë 1 i nenit 87 të ligjit.
3. Në rast mosveprimi nga ana e Asamblesë së Ortakëve për të vendosur shpërbërjen, për arsyet e përcaktuara në shkronjat « a », « c », « d », « dh » të paragrafit 1 të këtij neni, çdo person i interesuar mund të, në çdo kohë, të kërkojë në gjykatë për të vendosur shpërbërjen e shoqërisë.
4. Shpërndarja e shoqërisë, për rastet e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurën e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë, janë likuiduar për shlyerjen e përbashkët të detyrimeve ndaj kreditorëve ose kur gjykata kompetente për procedurën e falimentimit refuzon kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të mungesës së aktiveve të shoqërisë, për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.
5. Shpërndarja e shoqërisë në rastet e parashikuara nga shkronja "ç", e pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, e parashikuar në nenin 3/1 të këtij ligji.

### **Neni 20**

Likujdatori merr përsipër të drejtat dhe detyrat e Administratorëve që nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria cakton më shumë se një likujdator, përveç rasteve në të cilat akti i emërimit parashikon se ata veprojnë të pavarur nga njëri-tjetri, likujdatorët kryejnë bashkërisht të drejtat dhe detyrat sipas ligjit. Likujdatorët mund të autorizojnë njërin prej tyre për të kryer veprime të një kategorie të veçantë.

Likujdatori i nënshtrohet mbikëqyrjes së Ortakut dhe Administratorit/orëve.

### **Neni 21**


#### **Të drejtat dhe Detyrimet e Likujdatorëve**

1. Detyra e likujdatorëve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, njohja e kredive/huave dhe kontributeve të papaguara, shitja e aktiveve të shoqërisë dhe pagesa e kreditorëve duke respektuar urdhrin e referencës, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likujdatori mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, me qëllim mbylljen e një veprimi jo të plotë.
3. Nëse, në bazë të ankesave të kreditorëve, sipas nenit 194 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", likujdatorët vërejnë se pasuritë e shoqërisë tregtare, përfshirë edhe kontributet e papaguara, nuk janë të mjaftueshme për pagesën e këtyre kërkesave, likujdatorët janë të detyruar të pezullojnë procedurën e likujdimit dhe të kërkojnë nga gjykata fillimin e procedurës së falimentimit.
4. Likujdatori përgatit një bilanc në lidhje me gjendjen e shoqërisë në momentin e hapjes së likujdimit dhe një bilanc përfundimtar në momentin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likujdimit zgjat më shumë se një vit, likujdatori përgatit raportin financiar vjetor të shoqërisë. Buxhetet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

### **Neni 22**

#### **Finalizimi i likujdimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likujdatori njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likujdimit dhe kërkon mbylljen e shoqërisë, në



përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 05.03.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" e ndryshuar.

### **Neni 23** **Shkrirja**

Dy ose më shumë kompani mund të bashkohen përmes:

1. Transferimi i të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të një ose më shumë shoqërive, të quajtura shoqëri të inkuorporuara, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëri blerëse, në këmbim të aksioneve ose kuotave të asaj shoqërie.
2. Krijimi i një shoqërie të re, së cilës i kalojnë të gjitha aktivet dhe detyrimet e shoqërive ekzistuese, të cilat bashkohen në këmbim të aksioneve ose kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet shkrirje me krijimin e një shoqërie të re.

### **Neni 24** **Ndarja**

1. Një shoqëri mund të shkrihet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, duke transferuar të gjitha aktivet dhe detyrimet e saj në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese ose të sapokrijuara. Shoqëria e ndarë konsiderohet e shpërbërë.
2. Për shkrirjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.
3. Shoqëritë, të cilat thithin aktivet e shoqërisë që shkrihet, quhen shoqëri pritëse dhe janë plotësisht përgjegjëse për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:
  - a) kalimin tek shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë që shpërbëhet, në përputhje me marrëdhëniet e shkëputjes, të përcaktuara në kontratën e shkëputjes. Ky transferim ka pasoja në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, edhe për të tretët;
  - b) Vlerësimin e shoqërisë së shkëputur dhe mbyllja e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në zbatim të seksionit V të ligjit nr.9723, datë 05.03.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryer likuidimin.

### **Neni 25** **Konvertimi**

Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare.  
Konvertimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë në përgjegjësi ndaj palëve të treta.

### **Neni 26** **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.



**Neni 27**  
**Mosmarrëveshjet**

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin me zbatimin dhe interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

**Neni 25**  
**Dispozitat Përfundimtare**

Ky Statut është hartuar në 4 kopje me të njëjtën vlerë ligjore, në shqip dhe italisht dhe është miratuar në tërësi nga aksionerët e shoqërisë tregtare **"PERSPEKTIVE" Shpk.** Të gjitha kopjet e statudit nënshkruhen duke shkruar emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

**I SHOQËRISË "PERSPEKTIVE" Shpk**

TOBIA FIOCCINOTTI

